



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**VENDIM**

**Nr. 141, datë 02.12.2019**

**PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZONJËS JOANA ASIMI SORRAJ NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË, SHPALLUR NGA KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË DATËN 01.03.2019 DHE RISHPALLUR PËR PLOTËSIMIN E KANDIDATURAVE NË DATËN 09.09.2019**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

<b>Ardian Dvorani</b>	- Kryetar
<b>Vitore Tusha</b>	- Zëvendëskryetare
<b>Margarita Buhali</b>	- Anëtare/Relatore
<b>Fatjona Memçaj</b>	- Anëtare
<b>Eriol Roshi</b>	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

me praninë e Avokates së Popullit, **zonjës Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës **02.12.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATE PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË**

**Zonja Joana Asimi Sorraj**

**OBJEKTI:**

Urdhërimi i lejimit të kandidimit të zonjës **Joana Asimi Sorraj**, në vendin vakant për **Inspektor i Lartë i Drejtësisë**, të shpallur nga **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi** në datën **01.03.2019**, rishpallur për plotësimin e kandidatave në datën **09.09.2019**

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, zonjës **Margarita Buhali**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja **Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatës, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 01.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të procedurës së verifikimit të kandidaturave, meqenëse numri i kandidatëve për të cilët është lejuar kandidimi është nën atë të përcaktuar nga paragrafi 4 i nenit 147/d të Kushtetutës, me vendimin nr. 121, datë 09.09.2019, vendosi:

- Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Shpalljen e procedurës së thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....

3. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim në datën 20.09.2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, nëpërmjet Njoftimit për Media në faqen zyrtare, ka bërë publike në datë 23.09.2019 listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant, duke filluar shqyrtimin e aplikimeve të këtyre kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 199 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

4. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, është edhe zonja Joana Asimi Sorraj.

5. Në zbatim të nenit 147/d dhe 149/d të Kushtetutës dhe të nenit 199, 229, 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas njoftimit publik të datës 23.09.2019 për listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për kandidim, vijoi me zbatimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave të tyre, për të vazhduar më pas me procedurat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të të gjithë kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar në mbledhjen e datës 05.04.2019, për vendin vakant të krijuar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Margarita Buhali.

7. Zonja Joana Asimi Sorraj, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Joana Asimi Sorraj, gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

8. Në datën 25.09.2019, kandidatja Joana Asimi Sorraj është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

9. Në datën 27.09.2019, kandidatja Joana Asimi Sorraj ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatës.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 548 prot, datë 04.10.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Joana Asimi Sorraj, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr. 4186/1 prot, datë 14.10.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Joana Asimi Sorraj e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 112/25 prot., datë 31.10.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatës Joana Asimi Sorraj dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të saj për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë



11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatës Joana Asimi Sorraj dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatës Joana Asimi Sorraj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 09.10.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka AlphaAlbania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka IntesaSanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka OTP Albania, (9) Banka Procredit, (10) Banka Raiffeisen, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k, (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Joana Asimi Sorraj.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 556 prot, datë 09.10.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015 nga kandidata Joana Asimi Sorraj.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 2683/47 prot., datë 13.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatën Joana Asimi Sorraj.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatës Joana Asimi Sorraj, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr.

4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr. 555 prot, datë 09.10.2019), si edhe me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr. 557 prot, datë 09.10.2019).

20. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 3779prot., datë 21.11.2019 dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësishtme shkresat nr. 2154 prot., datë 22.10.2019 dhe nr. 2051/2 prot., datë 28.10.2019, mbi të dhënat e kërkuara për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe kandidaten Joana Asimi Sorraj.

21. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 554 prot, datë 09.10.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Joana Asimi Sorraj për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

22. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1375/4 prot., datë 25.10.2019, ka dërguar vendimin nr. 651, datë 23.10.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Joana Asimi Sorraj.

23. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” “d”, “dh” të pikës 1 të nenit 199, 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 - 93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Joana Asimi Sorraj në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidatja ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të saj.

24. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 16.10.2019 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, në përgjigje të këtyre kërkesave, partitë politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Joana Asimi Sorraj.

25. Në datë 11.10.2019, anëtarë i Këshillit relator i çështjes, i ka kërkuar me shkresë në rrugë elektronike kandidates Joana Asimi Sorraj të paraqesë shpjegime me shkrim në lidhje me sa më poshtë:

*1-Në zbatim të nenit 199/d të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë" ju duhet të paraqisni nga institucionet, ku keni punuar, vërtetime se nuk keni marrë masa disiplinore nga institucionet, ku ju keni qënë të punësuar për 3 vitet e fundit nga koha e kandidimit, në dosje rezulton që të jetë depozituar vërtetime në cilësinë e fotokopjes. Në këto kushte kërkojmë nga ana Juaj që vërtetimet të paraqitet në formën e kërkuar nga ligji.*

*2- Gjithashtu konstatohet që librezja e punës është paraqitur fotokopjes, kërkojmë nga ana Juaj që të paraqitet në formën e kërkuar nga ligji.*

*3-Po në zbatim të neni 199 pika dh të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë" kërkohet nga ana juaj të paraqisni; -një deklaram se nuk keni mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit".*

Gjithashtu me emailin e datës 22.11.2019 i është kërkuar:

*Nga studimi i Librezës tuaj të punës ndër të tjera rezulton e pasqyruar: Specialiste për Marrëdhëniet me gjyqësorin, për periudhën "30 janar 2013-31 janar 2014", pranë Presidentit të Republikës listë pritje.*

*Cili është mendimi juaj në lidhje me periudhën e sipërcituar, në raport me vjetërsinë në punë lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "c" e pikës 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016?*

26. Në datën 14.10.2019 dhe në datë 25.11.2019, kandidatja Joana Asimi Sorraj me procesverbalet nr. 652 prot, datë 14.10.2019 dhe nr. 652/1 prot, datë 25.11.2019 ka depozituar dokumentacion e kërkuar dhe ka njoftuar edhe në rrugë elektronike Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për paraqitjen e dokumentacionit.

27. Gjithashtu për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi ti drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave kandidatja Joana Asimi Sorraj ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidates si Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*shkresa nr.659 prot., datë 15.10.2019*), Departamentit të Administratës Publike (*shkresa nr.656 prot., datë 15.10.2019*) dhe Bashkisë Tiranë (*shkresa nr.656 prot., datë 15.10.2019*).

28. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*shkresa nr. 6560/1 prot., datë 22.10.2019*) Departamentit të Administratës Publike (*shkresa nr.6095 prot., datë 23.10.2019*) dhe Bashkia Tiranë (*shkresa nr.38798/1 prot., datë 27.11.2019*).

29. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", është proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, si dhe për shqyrtimin e pretendimeve të kandidates, në lidhje me vjetërsinë në punë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

30. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 02.12.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të zonjës Joana Asimi Sorraj, për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur



nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim të kandidaturave në datën 09.09.2019.

31. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatës Joana Asimi Sorraj.

32. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

33. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 02.12.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

34. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

35. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtarja relatore dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatës Joana Asimi Sorraj.

36. Ne thelb, Avokati i Popullit, parashtron: se për shkaqe të gjendjes së fatkeqësie natyrore, ka qenë e pamundur që grupi i punës në institucion ta ketë studiuar të plotë dosjen.

## **II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

37. Këshilli i emërimeve në Drejtësi u vu në dijeni me shkresën e datës 25.09.2019 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit se kandidatja Joana Asimi Sorraj pas kandidimit të saj në pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk afronte asistencë juridike në procesin e vettingut të anëtarit të KED z.Fatri Islamaj. Pasi erdhi në dijeni të kësaj rrethane, anëtari i KED Fatri Islamaj, referuar nenit 222 të ligjit nr.115/2016, dha dorëheqjen e tij nga pjesëmarrja në procedurën e verifikimit të kushteve të kandidimit dhe të vlerësimit të metejshëm të kësaj kadidate për të shmangur çdo konflikt interesi që mund të vinte për shkak të pjesëmarrjes së kandidatës në procesin e vettingut ndaj tij, proces i cili ende nuk kishte përfunduar dhe që kishte filluar prej muajit Nëntor 2018, pra rreth një vit më parë se momenti i kandidimit të kandidatës. Kërkesa për dorëheqje u miratua nga kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi sipas nenit 225 të ligjit nr.115/2016 me vendimin nr.10 datë 02.12.2019 .

38. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidatës Joana Asimi Sorraj për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emerimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim të kandidaturave në datën 09.09.2019.

39. Në pikën 3 të nenit 147/d të Kushtetutës, parashikohet se:

*“3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.”*

40. Në pikën 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se:

*“1. Inspektor i Lartë i Drejtësisë mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që në momentin e kandidimit përmbush këto kushte:*

*a) të jetë shtetas shqiptar;*

*b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;*

*c) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist;*

*ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;*

*d) nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;*

*dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;*

*e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.*

*ë) nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.”.*

41. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2015, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr. 112/25 prot., datë 31.10.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Joana Asimi Sorraj dhe personat e lidhur me të.

42. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Joana Asimi Sorraj, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) Nuk ka kryer deklarin të rremë;
- d) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

43. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidatja Joana Asimi Sorraj në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga



informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi.

44. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshillit i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklaratimet e bëra nga kandidatja Joana Asimi Sorraj pranë ILDKPKI me *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

45. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Joana Asimi Sorraj.

46. Për këto arsye, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Joana Asimi Sorraj ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

47. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidatja Joana Asimi Sorraj ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

48. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 2683/47 prot., datë 13.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Joana Asimi Sorraj, duke ardhur përfundimet se: *“Subjekti deklarues Joana Asimi Sorraj, candidate për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, nuk përfshihet në përcaktimet e nenit 2 të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.

49. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Joana Asimi Sorraj, krahas plotësimit të saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *“ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;”*. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

50. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidatja Joana Asimi Sorraj ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit *“Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”* parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

51. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1375/4 prot., datë 25.10.2019 ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Vendimin nr. 651, datë 23.10.2019 me rezultatet e kontrollit të ushtruar, duke ardhur përfundimet se për zonjën Joana Asimi Sorraj *“për shkak të moshës së saj nën 14 vjeç para 2 korrikut 1991, si datë fundore e zbatimit të ligjit nr. 45/2015, nuk është subjekt verifikimi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*.

52. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Joana Asimi Sorraj, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidatë nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

53. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Intelgjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidatja Joana Asimi Sorraj *“ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”*. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

54. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresat nr. 2154 prot., datë 22.10.2019 dhe nr. 2051/2 prot., datë 28.10.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar, të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Joana Asimi Sorraj: *“Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale”*.

55. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën me shkresën nr. 3779 prot., datë 21.11.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Joana Asimi Sorraj: *“Nuk disponohen materiale implikuese ose kompromentuese për integritetin e figurës së z. Joana Asimi Sorraj”*. Gjithashtu nga përgjigja e administruar nga organet kompetente nuk rezulton që znj. Joana Asimi Sorraj të ndodhet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas pikës 89/c të vendimit të KED nr.4/2019 dhe nenit 199/1/ë të ligjit nr.115/2016.

56. Prandaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Joana Asimi Sorraj nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

57. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 199, 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidatja Joana Asimi Sorraj në momentin e kandidimit për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidati ka ushtruar funksione publike ose

veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të saj.

58. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidatitë *ketëpërfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja Joana Asimi Sorraj ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 2003 si Juriste, në Universitetin e Leçes Itali, njohur me dëshminë për njohje diplomimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me nr. regjistri 217, datë 22.12.2005. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidatja Lindita Troja nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

59. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si jurist*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj. raporti përfundimtar i ILDKPKI , që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Joana Asimi Sorraj ka ushtruar veprimtari profesionale si:

1. Asistent Pedagoge, për periudhën “Janar 2004 – shtator 2005”, pranë Universitetit Ismail Qemali Vlorë;
2. Pedagoge, për periudhën “shtator 2005- 25 mars 2006”, pranë Universitetit Ismail Qemali Vlorë;
3. Specialiste pranë Këshilltarit Ligjor, për periudhën “27 mars 2006 – 07 nëntor 2007”, pranë Presidentit të Republikës;
4. Specialiste për Marrëdhëniet me gjyqësorin, për periudhën “7 nëntor 2007 – 30 janar 2013”, pranë Presidentit të Republikës;
5. Specialiste për Marrëdhëniet me gjyqësorin, për periudhën “30 janar 2013-31 janar 2014”, pranë Presidentit të Republikës listë pritje;
6. Juriste për periudhën 1 shkurt 2014 deri 30 shtator 2015 pranë projektit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Projekti “Shërbime Sociale Inovative”;
7. Specialiste, për periudhën “19 shkurt 2016 – 16 shkurt 2017”, pranë Bashkisë Tiranë.
8. Specialiste Drejtoria Juridike, për periudhën “16 shkurt 2017 – 30 nëntor 2017”, pranë Bashkisë Tiranë;
9. Këshilltare ligjore, për periudhën “ 1 dhjetor 2017 – Aktualisht”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
10. Lektore me kohë të pjesshme në Departamentin e Shkencave Juridike, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University Tiranë, për vitet akademike 2009 – 2015.
11. Asistent pedagoge e jashtme ne universitetin Luarasi për periudhën Tetor 2015 deri në Mars 2016.
12. Asistent pedagoge në Universitetin e Tiranës Fakulteti i Drejtësisë për vitin akademik 2017-2018.

60. Me emailin e datës 22.11.2019 Kandidates Joana Asimi Sorraj i janë kërkuar shpjegime si më poshtë:

*Nga studimi i Librezës tuaj të punës ndër të tjera rezulton e pasqyruar: Specialiste për Marrëdhëniet me gjyqësorin, për periudhën "30 janar 2013-31 janar 2014", pranë Presidentit të Republikës në listë pritje.*

*Cili është mendimi juaj në lidhje me periudhën e sipërcituar, në raport me vjetërsinë në punë lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "c" e pikës 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016?*

61. Me emailin e datës 24.11.2019 dhe procesverbalin nr. 652/1 prot, datë 25.11.2019 kandidatja ka sqaruar si vijon:

*Periudha e cituar në librezën e punës, 30 janar 2013, ku përcaktohet "kalon në listë pritje për shkak të ristrukturimit", trajtohej me Ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", ligj i cili në gërmën "a" të nenit 20 të tij, sanksionte të drejtën e nëpunësit civil për një punë të garantuar në shërbimin civil, në përputhje me dispozitat e ligjit.*

*Në kuadër të kësaj të drejte ishte edhe baza ligjore me anë të të cilës jam trajtuar pas ristrukturimit të institucionit, duke kaluar në listë pritje referuar pikës 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.360, datë 14.7.2000 "Për lirim nga shërbimi civil".*

*Dispozita e sipërcituar parashikon të drejtën e nëpunësit të larguar në kuadër të ristrukturimit të institucionit, të regjistrohet në listë pritje pranë Institucionit përkatës, me qëllim riemërimit pa konkurim të tij në një pozicion të lirë nëse ploteson kërkesat e veçanta për vendin e lirë.*

*Vendimi për kalimin në listë pritje, është shoqëruar edhe me pasojat ligjore financiare të tij, duke më trajtuar institucioni si punonjës të tij me pagën dhe përfitimet përkatëse (sigurime shoqërore/shëndetësore, pagesa tatimore, pagesë për vjetërsi etj) për një periudhë një vjeçare, deri 31 janar 2014, periudhë e cila përkon edhe me afatin maksimal të listës së pritjes duke qenë se nuk u emërova ndërkohë në një pozicion tjetër të barazvleshëm me atë që kisha përpara ristrukturimit të institucionit. Gjatë periudhës janar 2013 deri në janar 2014 jam angazhuar dhe në veprimtarinë e mësimdhënies pranë Departamentit të Shkencave Juridike, Fakulteti i Shkencave Shoqërore në "Albanian University", Tiranë, vërtetuar me vërtetimin nr.370 Prot, datë 14.12.2017.*

*Parashtrimin e sipërcituar e bazoj jo vetëm në kopjen e librezës së punës që kam depozituar por edhe në Vërtetimin e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit, nr.4384 prot., datë 21.11.2019, me atë të të cilit vërtetohet se kam qënë punonjëse e këtij institucioni për periudhën 25.03.2006 deri më datë 31.01.2014, duke cituar edhe pagën përkatëse.*

*Në lidhje me njohjen si vjetërsi në punë gjatë gjëndjes së listës së pritjes, është shprehur edhe Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, në Vendimin nr. 15, datë 29.01.2016 ku citohet se: "...në analizë të përmbajtjes të nenit 23 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe pikave 7-10, të Vendimit nr. 360, datë 14.07.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për lirim nga shërbimi civil", rezulton që lista e pritjes është një gjëndje e posaçme e nëpunësit civil, e cila përfitohet në kushte të caktuara nga ligji në fjalë dhe që ka në thelbin e vet, përfitimin e gjithë të drejtave të vendit të mëparshëm të punës (si psh., pagesën, sigurimet shoqërore, vjetërsinë në punë, etj) dhe mundësinë e sistemit në një pozicion të shërbimit civil pa konkurim, por me kufizimin që kjo nuk mund të zgjasë më shumë se një vit kalendarik...".*

*Në lidhje me bazën ligjore që Ju citoni në e-mail, në referencë të pikës 4 të nenit 125 të Kushtetutës, sqaroj se aplikimi im bazohet në pikën 3 të nenit 147/d të Kushtetutës, i ndryshuar, si dhe në pikën 1 shkronja "c", enenit 199 të Ligjit Nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të përmendur nga ana juaj.*

*Sa më sipër, aplikimi im për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është realizuar pas bindjes ligjore se i plotësoj të gjitha kriteret ligjore të tij, përfshi edhe atë të vjetërsisë në punë, duke qënë se edhe për periudhën 30 janar 2013 deri më 31 janar 2014, kam qënë pjesë*



*e stafit të Institucionit të Presidentit pa shkëputje, gjë e cila vlen jo vetëm për efekt të përfitimit ekonomik por edhe si vjetërsi në punë.*

*Bashkëlidhur po ju vendos në dispozicion:*

- 1. Kopje të noterizuar të vërtetimit nr.4384 prot., datë 21.11.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm, të Institucionit të Presidentit të Republikës.*
- 2. Kopje të noterizuar të librezë kontributesh për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, duke përfshirë pagesat për periudhën 30 janar 2013 deri më 31 janar 2014, nga Institucioni i Presidentit.*
- 3. Kopje të vërtetimit nr.370 Prot, datë 14.12.2017, të Rektorit të Albanian University, ku vërtetohet angazhimi im në veprimtarinë e mësimdhënies.*
- 4. Vendimin nr.15 datë 29.01.2016, të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil.*

62. Lidhur me faktin nëse periudha e vjetërsisë në punë e kandidates në listë pritje trajtohet apo jo si përvojë pune, pranë KED ka mbërritur shkresa e datës 02.12.2019 e Presidentit të Republikës i cili ka bashkangjitur dokumentacionin përkatës të periudhës së punës së kandidatet pranë institucionit të Presidentit të Republikës deri në kalimin e saj në listë pritje.

63. Duke analizuar në tërësi të gjithë dokumentacionin provues për përvojën e punës së kandidates Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se kandidatja *ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist*. Kështu sipas librezës së punës vërtetohet se; -për periudhën Janar 2004 deri në 30.01.2013 kandidatja ka mbajtur në vazhdimësi detyra si asistent pedagoge, pedagoge, specialiste e marrëdhënies me gjyqsor duke fituar një përvojë pune prej 9 vjet e 29 ditë. Për periudhën 01.02.2014 deri në datë 30.09.2015 pra për 1 vit e 8 muaj ka punuar juriste për periudhën pranë projektit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Projekti “Shërbime Sociale Inovative. Në periudhën “19 shkurt 2016 – 16 shkurt 2017”, pra për rreth 1 vit specialiste e sektorit të asistencës ligjore dhe legjislacionit pranë Bashkisë Tiranë. Për periudhën “16 shkurt 2017 – 30 nëntor 2017”, pra 9 muaj e 14 ditë si specialiste në drejtorinë juridike pranë Bashkisë Tiranë. Ndërsa për periudhën nga 01.12.2017 deri në datën 20.09.2019 që përkon me kohën e kandidimit gjatë rishpalljes së vendit vakant për Inspektor të lartë të Drejtësisë nga KED, rezulton se kandidatja ka një përvojë pune prej 1 vit e 9 muaj e 20 ditë si këshilltare ligjore në Komisionin e Pavarur të kualifikimit. Pra, gjithsej sipas librezës së punës kandidatja ka përvojë pune si juriste prej 14 vjet e 4 muaj e 4 ditë.

64. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se periudha e qëndrimit të kandidates në listë pritje nga data 31.01.2013 deri në 31.01.2014 pavarësisht se njihet si vjetërsi në punë për efekt të përfitimit të pagesës dhe të sigurimeve shoqërore sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 të ndryshuar, nuk mund të konsiderohet si përvojë pune. Gjatë kësaj kohe nëpunësi i shërbimit civil nuk ofron pune, por qëndron në pritje të sistemimit të tij në një vend tjetër pune në shërbimin civil pa konkurrim. Qëllimi i nenit 199/1/c të ligjit nr.115/2016 është që kandidati të ketë punuar për më shumë se 15 vjet. Prandaj periudha 31.10.2013 deri në 31.01.2014 në listë pritje nuk trajtohet si përvojë pune.

65. Megjithatë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se pikërisht në të njëjtën periudhë kandidatja rezulton të ketë përvojë pune si lektore e jashtme në Universitetin Albanian Universiti bazuar në vërtetimin e datës 14.12.2017 sipas të cilit ajo ka realizuar me kohë të pjesëshme detyrën e lektorës së jashtme në lëndët e Drejtë Romake dhe e drejta e Bashkimit Evropian për periudhën 2009-2015. Si punësim me kohë të pjesëshme, del se periudha një vjecare 31.01.2013 deri në 31.01.2014 llogaritet në 6 muaj. Gjithashtu edhe për periudhën Tetor 2015 deri në Shkurt 2016, kur kandidatja rezulton të jetë e papunë, vërtetohet se ajo ka punuar si lektorë e jashtme në Universitetin Luarasi me pagesë të deklaruar rregullisht në

formularin e deklarimit të pasurive duke shtuar përvojën në punë të saj edhe me këtë periudhë.

66. Nga sa mësipër rezulton se kandidatja ka 14 vjet e 7 muaj përvojë pune me kohë të plotë, për periudhën Janar 2013 deri në Janar 2014, pra 1 vit përvojë pune me kohë të pjesëshme dhe për periudhën Tetor 2015 deri në Shkurt 2016, pra 5 muaj përvojë pune me kohë të pjesëshme. Rezulton se periudha e kohës së pjesëshme të punës për 1 vit e 5 muaj, llogaritet si përvojë pune me kohë të plotë për afërsisht 8 muaj e 15 ditë. Duke iu shtuar kjo periudhë përvojes së punës për 14 vjet e 4 muaj e 4 ditë, që kandidatja i ka të provuar ligjërisht sipas librezës së punës vërtetohet se kandidatja ka më tepër se 15 vjet përvojë pune.

67. Bazuar në gjetjet e cituara më sipër, Këshilli konstaton se kandidatja Joana Asimi Sorraj ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016. Pozicioni i punës si këshilltare ligjore e mbajtur nga kandidatja në komisionin e pavarur të kualifikimit, pedagoges dhe lektore për një periudhë të konsiderueshme kohe nga viti 2004 e në vazhdim me vetem disa vite ndërprerje, specialistes së marrëdhënies me gjyqsorin në Institucionin e Presidentit e përfshin kandidaten në kategorinë e juristëve të spikatur. Duke mbajtur në konsideratë këto pozicione specifike të karrierës së kandidates dhe kushtin si jurist që kërkon neni 199/1/c të ligjit nr.115/2016, Këshilli vlerëson se kandidatja plotëson kushtin ligjor dhe kushtetues lidhur me pozicionin e punës, që ajo ka mbajtur për më shumë se 15 vjet.

68. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ...*, sikurse parashtrohet më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se kandidatja Joana Asimi Sorraj nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Joana Asimi Sorraj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

69. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit* nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondencat me partitë politike, Këshilli konstaton se kandidatja Joana Asimi Sorraj nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Joana Asimi Sorraj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

70. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati *nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit*. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidatja Joana Asimi Sorraj nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë kandidatja Joana Asimi Sorraj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.



71. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatës Joana Asimi Sorraj në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim të kandidaturave në datën 09.09.2019.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 147/d dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 199, pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të 236 dhe pikës 3 të 237 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

#### **VENDOSI:**

1. Lejimin e kandidimit të kandidatës Joana Asimi Sorraj, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur në datën 09.09.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Joana Asimi Sorraj.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI**

**Ardian DVORANI**



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Ardian DVORANI'. The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top, 'KESHILLI I EMERIMEVE NE DREJTESI' around the perimeter, and 'TIRANE' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.